

UDHËZIM

Nr. 176 , date. 04/04/2013

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR PAJISJEN ME AKT MIRATIMI PËR VEPRIMTARI ME BURIME TË RREZATIMIT JOJONIZUES

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 4 të Ligjit Nr. 10469, dt. 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese” dhe pikës 4.10 të VKM-së, Nr.743, datë 16.10.2012, të rregullores “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizues”;

UDHËZOJ:

Të gjithë personat juridikë dhe fizikë, publik dhe private që ushtrojnë veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues, janë të detyruar të paguajnë tarifën e mëposhtme për procesin e pajisjes me akt miratimi:

1. Telefonia celulare – Stacion baze	12 000 Lekë
2. Radioemetuesit (transmetimet radio)	15 000 Lekë
3. Stacionet e transmetimit televiziv	15 000 Lekë
4. Sistemet e radareve (Aeroport)	15 000 Lekë
5. Linjat e tensionit të lartë të transmetimit të energjisë dhe nënstacionet elektrike	12 000 Lekë
6. Aktivitete me burime të rrezatimit jojonizues në fushën e arsimit dhe shkencës	12 000 Lekë
7. Aktivitete me burime të rrezatimit jojonizues në mjekësi (Rezonanca magnetike)	15 000 Lekë

Pagesa e këtyre tarifave do të bëhet në numrin e llogarisë ku kryhet veprimtaria e Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet.

Ngarkohet Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
KRYETAR I KOMISIONIT TË MBROJTJES NGA RREZATIMET
VANGJEL TAVO